



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 12, DATË 23 / 07 / 2024

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË STATUSIT PROJEKT ME POTENCIAL STRATEGJIK
PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “PARKU I ENERGJISË DIELLORE 190 MW DHE
TË ERËS 636 MW, TROPOJË” ME SUBJEKT APLIKUES ERALB INVEST 2 SHPK,
NUIS M21823010B**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 14, nenit 18 dhe nenit 22 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu II, pika 8 e VKM-së Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, VKM-së Nr. 1024, datë 16.12.2015 “Për Miratimin e Projekteve me Statusin ‘Projekt me Potencial Strategjik’” si dhe bazuar në Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 30/8, datë 06.06.2023 “Për miratimin e Statusit ‘Projekt me Potencial Strategjik Parku i Energjisë Diellore 190 MW dhe të Erës 636 MW, Tropojë’”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Komiteti i Investimeve Strategjike me Vendimin Nr. 30/8, datë 06.06.2023 vendosi miratimin e Statusit “Projekt me Potencial Strategjik” për projektin e investimit “Parku i energjisë diellore 190 MW dhe të erës 636 MW, Tropojë” propozuar nga subjekti Eralb Invest 2 shpk, me NUIS M21823010B.
- Statusi “Projekt me potencial strategjik” iu dha projektit të investimit “Parku i energjisë diellore 190 MW dhe të erës 636 MW, Tropojë” propozuar nga subjekti Eralb Invest 2 shpk,

për një periudhë 6 (gjashtë) mujore. Brenda kësaj periudhe, subjekti Eralb Invest 2 shpk duhet të aplikonte për përfitimin e statusit përfundimtar ‘Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë’.

- Subjekti ndau projektin në faza, ku faza e parë do të fillonte me një fushatë matëse të burimeve të erës, faza e dytë do të përcaktonte gjurmën e saktë të projektit me vendndodhje të saktë për secilën turbinë dhe faza e tretë do të konsistonte në aplikimin për sa i përket përfitimit të statusit përfundimtar “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”.
- Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, masat mbështetëse që iu aprovuan projektit me potencial strategjik ndër të tjera përfshinin:
 - a) Miratim në parim i së drejtës për marrjen në përdorim të tokës për efekt “studim prone” për të krijuar mundësinë e kryerjeve të matjeve në terren sipas vendimit/ve të miratuar nga Këshillit Bashkiak;
- Projekti është i pajisur me Vendim të Këshillit Bashkiak Tropojë me Nr.120, datë 22.12.2022 "Për dhënien në përdorim të një sipërfaqeje prej 40 ha, me qëllim matjen e intensitetit të erës në territorin pronë publike e Bashkisë Tropojë".
- Ndërmjet Bashkisë Tropojë dhe subjektit Eralb Invest 2 është lidhur kontrata e qirasë me nr. 4807/2 prot., datë 31.10.2023 “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor publik” për një sipërfaqe prej 31.06 ha. Sipas kësaj kontrate ngastrat e kërkuara nga subjekti nuk përputheshin me ngastrat e vëna në dispozicion nga Bashkia Tropojë, ndaj implementimi i projektit lidhur me zbatimin e fazës së parë, fazës së matjes në terren të burimeve të erës, u bë i pa realizueshëm për shkak të këtyre mospërputhjeve.
- Pas saktësimit dhe verifikimit të sipërfaqeve sipas koordinatave të gjurmës së synuar, ndërmjet Bashkisë Tropojë dhe subjektit Eralb Invest 2 u lidh kontrata e qirasë Nr.1086/9 prot., datë 18.04.2024 “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor publik” për një sipërfaqe prej 39.02 ha me afat 10 vjeçar.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të Statusit “Projekt me Potencial Strategjik” për projektin e investimit strategjik “Parku i Energjisë Diellore 190 MW dhe të Erës 636 MW, Tropojë”, i cili realizohet nga subjekti Eralb Invest 2 sh.p.k. me NUIS M21823010B për një periudhë 6 (gjashtë) mujore. Brenda kësaj periudhe, subjekti Eralb Invest 2 shpk duhet të aplikojë për përfitimin e statusit përfundimtar “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”.
2. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Parku i Energjisë Diellore 190 MW dhe të Erës 636 MW, Tropojë” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet investitorit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE
ERVIN METE

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT
ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
LAURA PLAKU (SARO)